

## Historia e letërsisë shqipe dhe kultura e letërsisë shqipe: vëzhgime mbi zhvillimet e fundit

Botimi në Tiranë në vitin 1983 i vëllimit standard “Histori e Letërsisë Shqiptare” ishte njëherazi një arritje thelbësore për studimet shqiptare dhe një tragjedi kombëtare. Ky vëllim prej 629 faqesh, i titulluar *Historia e letërsisë shqiptare: që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacionalçlirimtare*, u botua - me bekimin e Partisë së Punës së Shqipërisë - nga Akademia shqiptare e Shkencave nën drejtimin e të ndjerit Dhimitër Shuteriqi (1915-2003). Siç shihet nga titulli, ai merret me historinë dhe zhvillimin e shkrimit artistik në gjuhën shqipe nga tekstet më të hershme deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Autorët e tij më kryesorë ishin të tërë studiues nga Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Tiranë, përfshirë këtu Ali Xhikun për letërsinë e vjetër shqipe të shekujve gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë, Shaban Çollakun (1940-1993) për letërsinë e vjetër të traditës myslimane, Klara Kodrën (l. 1944) për letërsinë e italo-shqiptarëve, Razi Brahimin (l. 1931) për letërsinë e Rilindjes së shekullit të nëntëmbëdhjetë, Dhimitër Fullanin për letërsinë e fillimit të shekullit të njëzetë dhe Vehbi Balën (1923-1990) për periudhën politikisht më të ndjeshme të para 1939. Kontribute të rëndësishme janë shkruar nga Jorgo Bullo (l. 1939) dhe Mahir Domi (1915-2000). Ky vëllim zëvendësoi dhe përmirësoi rrënjësisht një botim më të hershëm dyvëllimësh të Akademisë që u shtyp në vitin 1959.

Historia e letërsisë e vitit 1983 përshkruante rrjedhën kryesore të letërsisë shqipe deri në vitin 1939, duke trajtuar, në një mënyrë shumë më përfshirëse, të detajuar dhe të kujdesshme se sa botimi i dobët i 1959, kahjet dhe lëvizjet e saj të ndryshme kulturore. Rëndësia kryesore e tij ishte se shërbeu si një guidë standarde enciklopedike për një brez të tërë shqiptarësh si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, duke u përdorur në procesin mësimor në të gjitha shkollat dhe universitetet. Ai u tregonte shqiptarëve atë që ata kishin nevojë të dinin dhe, ndoshta më tepër akoma, atë çka ata duhej të mendonin rreth letërsisë së tyre kombëtare. Në të vërtetë ai krijoi dhe/ose riprodhoi shumë pikëpamje të ngurta mbi kulturën dhe letërsinë shqipe - disa prej tyre shumë të gabuara - të cilat kanë ardhur deri në ditët tona. Nga pikëpamja shkencore moderne, ai është një libër primitiv dhe në thelb i dëmshëm. Megjithatë, do të ishte jo e ndershme të denigroheshin të gjithë autorët dhe kontribuuesit e tij, shumë prej të cilëve po bënin të pamundurën në kushte jashtëzakonisht të vështira. Nuk duhet harruar se Kongresi i Katërt i Partisë i 1973, Revolucioni Kulturor dhe spastrimet e mëvonshme i kishin terrorizuar shkrimtarët, studiuesit dhe intelektualët shqiptarë, duke i detyruar të tërë të nënshtroheshin. Jo vetëm që shqiptarët jetonin në një izolim pothuajse të plotë nga bota e jashtme, por shumë prej

autorëve nuk ishin aq të moshuar sa të kishin njohur ndonjë gjë tjetër përveç regjimit komunist, të cilit po i shërbenin. Përjashtimi i vetëm ishte Dhimitër Shuteriqi, kryeredaktori i botimit të 1983, i cili kishte qenë jashtë në vitet 1930, por që vendosi ta lidhte fatin e tij me partizanët komunistë. Çfarëdo që mund të thuhet për kompromiset politike dhe personale që ai bëri gjatë jetës së tij, Shuteriqi mbeti një studiues i pasionuar i letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe, në njëfarë mënyre, ishte pionier i saj.

Studime të tjera letrare të botuara në Tiranë në kohën e diktaturës, siç ishte *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* botuar në 1978, nën drejtimin e Koço Bihikut, dhe *History of Albanian Literature* nga i njëjti autor, botuar në 1980 në anglisht dhe frëngjisht për konsum të jashtëm, në italisht në 1981 dhe në rusisht në 1983, nuk duhen marrë seriozisht.

Çfarë e bën historinë e letërsisë shqipe një “tragjedi kombëtare”, ashtu siç kam pohuar më sipër? Në thelb, ajo përshkohet fund e krye nga dy ideologji ekstremiste – ose nga pikësynime/agjenda, siç përdoret në gjuhën e sotme – që e bëjnë atë pothuaj të papërdorshme si një mjet objektiv kërkimor. Së pari, ajo është e mbrujtur me një interpretim primitiv stalinist të socializmit, duke i parë pesë shekuj të shkrimit nga këndvështrimi i luftës së klasave. Ajo i fut pothuaj të gjithë autorët, madje edhe ata të shekujve të mëparshëm, në kategoritë e cekëta të atyre politikisht progresistë dhe politikisht reaksionarë. Nuk është e nevojshme të thuhet këtu se, të ashtuquajturit reaksionarë trajtohen në mënyrë të kufizuar, shpesh shumë ashpër, ose nuk përmenden fare. Shembulli më i mirë në këtë drejtim është pasazhi i shkurtër dhe skandaloz që i kushtohet Gjergj Fishtës, të cilit, me botimin në vitin 1937 të versionit përfundimtar të epikës së tij kombëtare prej 15.000 vargësh *Lahuta e Malcis*, iu thurrën lavde si Homeri shqiptar dhe, përpara Luftës së Dytë Botërore, shihej botërisht si poeti kombëtar i Shqipërisë. Trajtimi prej 40 faqesh që i bëhej Fishtës ishte shkruar nga Vehbi Bala, një mbulim ky i barabartë me atë që i ishte bërë Naim Frashërit, por që nuk u lejua të botohej. Në vend të tij doli pasazhi vijues, të cilin e kam sjellë këtu të plotë:

*"Përfaqësuesi më kryesor i këtij kleri, Gjergj Fishta (1871-1940), poet, publicist, pedagog, politikan, drejtoi për një kohë të gjatë shtypin e urdhërit françeskan dhe veprimtarinë kulturore e arsimore të këtij urdhëri. Për të, interesat e kishës e të fesë qëndronin mbi interesat e atdheut e të popullit, gjë që ai e shpallte dhe e mbronte me tërë demagogjinë, por edhe cinizmin, dhe e kishte vënë në themel të punës së tij si letrar. Vepra e tij kryesore, poema epike 'Lahuta e Malësisë', duke sulmuar shovinizmin e fqinjëve të Veriut, propagandonte antisllavizmin dhe vinte në plan të dytë luftën kundër pushtuesit osman. Ajo i ngrinte himnin patriarkalizmit e bajraktarizmit, obskurantizmit fetar e klerikalizmit, dhe spekullonte me ndjenjat patriotike, kur ishte fjala për të ngritur lart ngjarje dhe figura të historisë kombëtare të periudhës së Rilindjes sonë. Vepra të tjera, si poema satirike 'Gomari i Babatasit', ku u sulmuan me tërbim laicizmi i shkollës dhe idetë demokratike, ishin karakteristike të luftës së egër që bëri kleri katolik për të ruajtur e për të rritur ndikimin e tij në jetën mendore të vendit. Këtij arti përpiqej t'i shërbente një formë që i qëndronte pranë folklorit. Atë e shoqëronin shpesh proliksiteti, efektet e kërkua,*

*retorizmi, brutaliteti i shprehjes e i stilit, gjer në banalitet, argumentimet e tyre false, që orvaten të imponohen me pahir, si dhe një qëndrim i theksuar konservator në lëmin e gjuhës. Fishta i mbaroi ditët si akademik i Italisë fashiste."*<sup>1</sup>

Autorë të tjerë të rëndësishëm si Faik bej Konica (1875-1942) dhe, në veçanti, shumë shkrimtarë të talentuar të kulturës katolike të Shkodrës, nëse nuk përmendeshin, refuzoheshin egërsisht.

Së dyti, historia e letërsisë e vitit 1983 është e përshkuar tej e ndanë nga një ideologji po aq e dëmshme siç është nacionalizmi shqiptar. Shkrimi artistik në shqip interpretohet nga fillimi në fund si një akt patriotizmi. Ndërkohë që kjo mund të qëndrojë për disa raste dhe vërtet ka pasur lidhje të forta midis rritjes së letërsisë shqipe dhe lëvizjes kombëtare, ndokush mund të shpresojë më kot se do të gjendet në tekst ndonjë shkrimtar shqiptar, dhe kjo sa për variacion, që të mos ketë qenë një "patriot" që luftonte kundër pushtuesve të huaj të mallkuar. Mendohej se letërsia e nivelit të mirë duhej të ishte një letërsi patriotike dhe çdo gjë tjetër ishte sipërfaqësore.

Historia e letërsisë e vitit 1983 nuk guxonte të shkonte deri pas vitit 1939, megjithëse fare mirë mund të kapte dekadat e para të letërsisë socialiste deri, për shembull, në vitin 1970. Edhe për letërsinë e gjysmës tjetër të kombit shqiptar- atë të Kosovës dhe të trojeve të tjera në ish Jugosllavi të banuara nga shqiptarë- nuk thuhej ndonjë gjë e madhe.

Me gjithë këto kufizime të rënda, "Historia e Letërsisë Shqiptare" e vitit 1983 u rishtyp me tirazhe të mëdha, më së voni në Prishtinë në 1990 dhe përdoret ende, edhe sot që po shkruajmë, në shkollat dhe universitetet shqiptare si një libër guide bazë për letërsinë shqipe dhe kulturën e shkruar.

I jam referuar botimit të 1983 në mënyrë paksa polemizuese si një "tragjedi kombëtare". Kjo nuk është bërë me qëllimin për të promovuar punën time të fundit *Albanian Literature: a Short History* (Londër 2005), versioni shqip i së cilës, i sapo botuar, mban titullin *Letërsia shqipe: një histori e shkurtër* (Tiranë 2006), por për të theksuar ndikimin që ushtrojnë ende sot mbi mendimin bashkëkohor të botës shqiptare veprat e hershme të studimeve me frymë staliniste dhe të dala kohe. Nuk dëshiroj të jap përshtypjen se studiuesit bashkëkohorë shqiptarë shikojnë pas me nostalgji periudhën e komunizmit. Sigurisht që nuk është ky rasti. Komunizmi si ideologji u fashit në mendjet e shqiptarëve shumë kohë para rënies së diktaturës në vitet 1990-1991. Nuk ka mbetur më nostalgji për komunizmin, të paktën, te asnjë që është më pak se shtatëdhjetëepesë vjeç. Por, ka ende mbetje të ideologjisë së vjetruar etnocentrike, e cila, e kapur pas pretendimesh të ekzagjeruara, vazhdon t'i japë tonin dhe të shtrembërojë punimet studimore në fushën e letërsisë dhe të kulturës shqiptare. Të njëjtat prirje shfaqen edhe në fushën e historiografisë, kur ende sot u besohet përshkrimeve të dala kohe të historisë së Shqipërisë - këto

---

<sup>1</sup> Dhimitër Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqiptare që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacionalçlirimtare*. Tiranë 1983, 470-471.

të fundit të paraqitura në formën e luftës midis së mirës, do të thotë çështja kombëtare, dhe së keqes, që është çdo gjë tjetër.

Me pak fjalë, ato që kërkohen janë punime të reja, të detajuara, autoriteteve dhe të besueshme mbi letërsinë shqiptare, historinë dhe kulturën, të shkruara dhe të hartuara nga studiues dhe specialistë vendas, punime që të jenë plotësisht të depolitizuara dhe të ndara sa më shumë të jetë e mundur nga ideologjitë dhe përdorimet politike. Për sa i takon situatës aktuale, shkollat dhe universitetet do të vazhdojnë të përhapin dhe të mbajnë gjallë pikësynime të gabuara dhe këndvështrime naive.

Periudha pas rënies së diktaturës nuk ka qenë një kohë e lehtë për studimet shqiptare. Shembja e strukturave shtetërore në Shqipëri dhe Kosovë çoi në një mungesë të paparë më parë të fondeve për studiuesit e punës kërkimore, mësuesit dhe profesorët. Me rroga zyrtësisht të ulta dhe në kushte primitive pune, studiuesit nuk janë të motivuar për të ecur përpara në fushat e tyre. Rrjedhimisht, shumë kohë dhe energjitë e tyre harxhohen në gjetje të burimeve të tjera të të ardhurave për të mbështetur familjet e tyre. Më shqetësuesja është mungesa e një brezi të ri studiuesish në fushën e studimeve shqiptare që do të zëvendësonte brezin e vjetër të tanishëm. Kësisoj, ka shumë pak punime të reja dhe origjinale- shumë prej botimeve më të vonshme janë rishtypje e punëve më të hershme ose përkthime të reja në shqip të veprave të huaja klasike në fushën e studimeve shqiptare. E ardhmja nuk është e ndritur për këtë fushë.

Por le t'i lemë studimet shkencore dhe t'i kthehemi letërsisë dhe botimeve të librave në përgjithësi. Këtu, në një dritë më pozitive, shohim se, më shumë se kurrë ndonjëherë, tani ka më tepër shtëpi botuese dhe më shumë libra që shtypen. Libraritë janë plot e për plot me libra dhe, duke ditur tregun e vogël të gjuhës shqipe, çuditësh se kush mund t'i lexojë ato të gjithë. Në mënyrë të veçantë, në fushën e letërsisë artistike libra të rinj kanë vërshuar nëpër pikat e shitjes dhe numri i tyre rritet çdo vit.

Pas dekadash izolimi, është e kuptueshme që shqiptarët të jenë më tepër të interesuar të lexojnë letërsi të huaj se sa veprat e autorëve të tyre dhe, prandaj, botimet më të vona të veprave letrare janë në një masë në rritje libra të huaj që përkthehen në shqip. Letërsia e shkruar në shqip tani zë një vend më të vogël në tregun e librit, ndonëse kjo sigurisht nuk do të thotë se ka rënie të prodhimit të librit.

Prirja e parë e letërsisë së sotme shqiptare që të bije në sy është shtimi i madh i veprave në prozë. Deri pesëmbëdhjetë vite më parë, pjesa më e madhe e veprave letrare të shkruara dhe të botuara në shqip ishin vëllime poezish, një fenomen ky që nuk mund të mendohet për botën perëndimore, ku poezia zë më pak se dy përqind të botimeve letrare. Ndërkohë që poezia shqipe nuk është në rënie dhe vëllimet me poezi ende përbëjnë një shumicë të dukshme të botimeve artistike, sot ka një treg disi më të madh për romanin, tregimet e shkurtra dhe gjinitë e tjera. Nëse do t'i hidhnim një sy botimeve të reja të kataloguara nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë për vitet 1995, 2000 dhe 2004, do të hasnim shifrat e mëposhtme:

Viti	Vëllimet me poezi shqipe	Romani shqip	Vëllimet e tregimit të shkurtër	Vëllimet me dramë shqipe	Letërsia shqipe në total	Letërsia e huaj e përkthyer në shqip
1995	136	26	37	6	205	27
2000	224	62	67	9	362	92
2004	274	95	55	6	430	199

Midis viteve 1995 dhe 2004, numri i vëllimeve me poezi të shkruara në shqip në origjinal u dyfishua, por numri i romaneve të shkruara dhe të botuara në shqip pati një rritje prej 365%. Këtu është e rëndësishme të vërehet rritja tepër e madhe e përkthimeve në shqip të letërsisë nga gjuha të huaj. Në vitin 1995, këto përkthime përbënin vetëm 11% të totalit të botimeve të letërsisë artistike. Në vitin 2000, ky proporcion u ngrit te 20% dhe në 2004 njohu një rritje prej 31%.

Prozatorë shqiptarë kanë mësuar dhe kanë përfituar nga kontaktet e tyre me letërsinë botërore. Në të njëjtën kohë, siç e pamë nga statistikat, ata po ndeshin në vështirësi të mëdha në përballjen me konkurrencën e huaj. Ndonëse shpesh herë përkthimet janë të dobëta, shumë lexues shqiptarë, pas vitesh të tëra përvoja të hidhur, i janë larguar letërsisë shqipe dhe tani janë të orientuar ekskluzivisht nga letërsia botërore e përkthyer në shqip. E vërteta në lidhje me këtë është se, me përjashtim të veprave të Ismail Kadarese, pak romane shqiptarë të botuar në Tiranë në mesin e viteve 1990 i kaluan 100 kopje të shitura. Megjithatë, pavarësisht konkurrencës së ashpër që vjen nga përkthimet, proza dhe poezia shqipe kanë mbijetuar dhe po lulëzojnë në një kontekst modest, siç është ai i tregut shqiptar.

Gjithsesi, ka një numër të mirë shkrimtarësh dhe poetësh në Shqipëri që shkruajnë vepra që mund të lexosh, shumë prej të cilëve janë tepër të rinj për të qenë të ndikuar nga tmerret e së kaluarës politike shqiptare. Ata janë rritur në një mjedis të ri dhe më të hapur dhe po japin ndihmesën e tyre për të sjellë një ajër të freskët në atmosferën e dikurshme të ndenjtur dhe mbytëse të kulturës së shkruar shqiptare.

Duhen thënë disa fjalë për përhapjen e letërsisë shqipe jashtë. Shumë autorë shqiptarë e shohin veten të suksesshëm vetëm kur veprat e tyre përkthehen në gjuhë të huaja dhe botohen jashtë dhe harrojnë se lidhjet e tyre të natyrshme janë me lexuesit shqipfolës. Pengesa kryesore për përhapjen e letërsisë shqipe në botë është mungesa e përkthyesve të letërsisë artistike nga gjuha shqipe. Në një seminar për përkthimin të mbajtur në Shkodër në vjeshtë të 2004, kam mbajtur shënimin vijues:

*“Sot, si edhe gjithmonë, ka një mungesë të theksuar të përkthimeve artistike nga gjuha shqipe. Për shembull, për letërsinë shqipe në anglisht ka vetëm dy ose tre përkthyes artistikë të cilët për momentin nuk janë shumë aktivë. Gjendja është paksa më mirë për*

*gjuhën frënge, ku ka pesë përkthyes artistikë, tre nga të cilët janë aktivë. Në italisht ka tre deri në pesë përkthyes, shumë prej të cilëve janë italo-shqiptarë. Në gjermanisht dhe polonisht ka dy përkthyes aktivë për secilën gjuhë, në bullgarisht tre dhe në spanjisht një. Ka gjithashtu edhe përkthyes aktivë të shqipes në holandisht dhe greqisht. Megjithatë, shumë pak prej këtyre përkthyesve janë profesionistë që punojnë gjithë kohës. Ata janë thjesht individë që përkthejnë vepra nga letërsia shqipe me raste, kur kanë kohë apo kur ia dalin të gjejnë ndonjë botues”.*

I vetmi shkrimtar shqiptar që ia ka dalë të shfaqet në skenën botërore është Ismail Kadare (l. 1936), fitues i çmimit Man Booker International 2005, i cili është një autor i respektuar në Francë dhe që tani njihet në shumë vende të tjera të botës. Në të vërtetë, nëse ndodh që një i huaj të njohë emrin e ndonjë shkrimtari shqiptar ka shumë mundësi që ai të jetë Ismail Kadareja. Nga librat e tij janë përkthyer rreth 35 në frëngjisht, 24 në greqisht, 23 në spanjisht, 20 në holandisht, 15 në gjermanisht dhe 12 në anglisht.

Nga shkrimtarët e tjerë që merren me prozë duhen përmendur përkthimet në frëngjisht nga Fatos Kongoli (l. 1944), Ylljet Aliçka (l. 1951), Besnik Mustafaj (l. 1958), Eqrem Basha (l. 1948), Elvira Dones (l. 1960), Zija Çela (l. 1946), Dritëro Agolli (l. 1931), Bashkim Shehu (l. 1955), Rexhep Qosja (l. 1936), Elena Kadare (l. 1943), Luan Starova (l. 1941), Neshat Tozaj (l. 1943), Maks Velo (l. 1935), Stefan Çapaliku (l. 1965) dhe Virion Graçi (l. 1968); në gjermanisht së fundi janë përkthyer Fatos Kongoli, Beqë Cufaj (l. 1970), Rexhep Qosja, Luan Starova, Besnik Mustafaj, Kasëm Trebeshina (l. 1962) dhe Kim Mehmeti (l. 1955); në italisht Diana Çuli (l. 1951), Elvira Dones, Fatos Kongoli, Mitrush Kuteli (1907-1967), Besnik Mustafaj, Bashkim Shehu dhe Visar Zhiti (l. 1952); dhe përkthimet e fundit në spanjisht nga Mitrush Kuteli dhe Bashkim Shehu.

Tregu i gjuhës angleze, shumë më i madh por shumë më i vështirë për t’u depërtuar, do të shohë shumë shpejt përkthime të reja nga Fatos Kongoli dhe Bashkim Shehu, autorët e parë që i bashkëngjiten veprave të Kadaresë. Përveç kësaj, në Çikago është botuar një antologji e parë e prozës shqiptare, *Balkan Beauty, Balkan Blood*.

Përsa i përket botimeve të poezisë si përmbledhje individuale, kemi përkthimet në frëngjisht nga Ali Podrimja (l. 1942), Ismail Kadare, Din Mehmeti (l. 1929), Luan Rama (l. 1952) dhe Preç Zogaj (l. 1957). Së shpejti do të dalin edhe vëllimet e Dritëro Agollit, Fatos Arapit (l. 1930) dhe Xhevahir Spahiut (l. 1945). Në gjermanisht janë përkthyer Sali Bashota (l. 1951), Martin Camaj (1925-1992), Ali Podrimja, Azem Shkreli (1938-1997) dhe Vaxhid Xhelili (l. 1960); në italisht janë përkthyer vëllimet e Diamant Abrashit (l. 1963), Mimoza Ahmetit (l. 1963), Martin Camajt, Gëzim Hajdarit (l. 1957) dhe Visar Zhitit; në spanjisht nga Mimoza Ahmeti dhe Xhevdet Bajraj (l. 1960).

Në anglisht janë botuar përkthimet e mia të fundit nga Ali Podrimja, Eqrem Basha, Flora Brovina (l. 1949), Visar Zhiti dhe së shpejti do të shohë dritën e botimit përkthimi nga Azem

Shkreli. Ndërkohë janë botuar në anglisht edhe përkthime nga Luljeta Lleshanaku (l. 1968) dhe Martin Camaj. Sigurisht që ka shumë poetë shqiptarë të cilët janë përfshirë në antologji dhe revista, si edhe në internet. Antologjia e zgjeruar e poezisë shqiptare e shkruar nga unë, me titull *Lightning from the Depths*, do të dalë në anglisht vitin që vjen.

Një gjini e letërsisë shqiptare e lënë pas dore, si drama, ka pasur kohët e fundit përkthime në frëngjisht të veprave të Ilirian Bezhanit (l. 1949), Minush Jeros (1932-2006), Anton Pashkut (1937-1995) dhe Teki Dervishit (l. 1943).

Ekzistenca e përkthimeve në gjuhë të huaja nuk është gjithmonë tregues i prestigjit apo rëndësisë, nëse do të shpreheshim kështu, që gëzojnë autorët shqiptarë brenda vendit. Shumë prej përkthimeve marrin shkas nga takimet rastësore midis autorëve dhe përkthyesve dhe jo domosdoshmërisht se përkthyesi e ka studiuar më parë tregun e librit dhe ka zgjedhur autorët më të përshtatshëm dhe përfaqësues.

Fatkeqësisht në Shqipëri nuk ka një traditë të kritikës letrare. Natyrisht që botimet e reja njoftohen në faqet e gazetave dhe të revistave, por ato janë të mbushura me panegjirizma dhe shpesh herë, e për më tepër, të shkruara nga gazetarë, ose në shumë raste, nga miq të autorit në fjalë. Në Tiranë ende nuk ka një kritik letrar profesional dhe të respektuar dhe vështirë se do të dalë ndonjë i tillë në vitet në vazhdim. Në Tiranë mungojnë po ashtu studime të mbështetura dhe të besueshme mbi letërsinë shqiptare bashkëkohore. Rrjedhimisht, lexuesi shqiptar është mosbesues dhe i çorientuar dhe ka një dyshim në rritje në publik nëse autorët shqiptarë do të arrijnë të prodhojnë ndonjë vepër me vlerë të qëndrueshme. Çdokush që ka parë gjendjen katastrofike të pothuaj çdo gjëje në Shqipëri - infrastrukturës, p.sh. rrugët, sistemin arsimor, spitalet, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, etj. - do të ishte i justifikuar nëse do të dyshonte se edhe letërsia shqiptare dergjet në të njëjtën gjendje prapambetjeje. Për fat të mirë, tek-tuk gjinden vepra të shkëlqyeshme.

Ajo që i bashkangjitet çorientimit të përgjithshëm dhe dyshimit mbi vlerat e librave të rinj që dalin në treg është fakti se shumë prej botuesve janë në mënyrë të kuptueshme të tërhequr pas fitimit të shpejtë dhe ata priren të kërkojnë parapagesë në pará të thata për botimin e një libri, në fakt të çdo libri. Pas dekadash të një kontrolli të plotë mbi industrinë e botimeve, në vitet nëntëdhjetë nuk kishte më kontrolle mbi librat, as botues të mirëfilltë dhe as rishikim të teksteve përpara botimit. Cilido që kishte pará ose gjente një sponsor mund të botonte dhe të tregtonte çfarëdo gjëje që ai ose ajo dëshironte.

Një tjetër fenomen që ka pasur një ndikim negativ vitet e fundit mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare dhe, mund të thuhet, mbi shoqërinë shqiptare në tërësi, ka qenë emigrimi masiv. Pas shkërrmoqjes së shtetit shqiptar në mars të 1997, pas rënies së investimeve piramidale dhe plaçkitjes së iu bë pikave ushtarake dhe depove të armëve nëpër të gjithë vendin, shumë të rinj besonin se në vendin e tyre nuk kishte më një të ardhme për ta. Vështirësitë dhe privacionet kanë qenë gjithmonë pjesë përbërëse e jetës në Shqipëri, por durimit atë kohë i erdhi fundi. Aty

nga fundi i shekullit të njëzetë, një pjesë e mirë e shkrimtarëve dhe intelektualëve, të rinj dhe të vjetër, kishin ikur nga Shqipëria në kërkim të një jete më të mirë. Pak prej tyre do të kthehen ndonjë ditë.

Fillimi i viteve nëntëdhjetë shënoi një pikë kthese edhe për shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë. Regjimi komunist në Jugosllavi ra, siç ra edhe vetë Jugosllavia. Shqiptarët në Kosovë, nën sundimin e egër serb, përballeshin me një diskriminim të tmerrshëm, me atë të persekutimit etnik sistematik, i cili në fund çoi në spastrim etnik. Politikisht, vendi u fut në një spirale rëniesje e cila pashmangshmërisht përfundoi me luftën e 1999, por edhe me çlirimin final pas gjithë atyre vitesh vuajtjeje.

Në ndryshim nga kolegët e tyre në Shqipëri, shkrimtarët në Kosovë nuk kishin as dëshirë dhe as qëllim të iknin nga vendi i tyre. Ata i ishin përkushtuar vendosmërisht ndërtimit të një shteti të ri. Megjithatë, në gjysmën e dytë të viteve nëntëdhjetë, gjendja politike dhe ekonomike e Kosovës u bë kaq e paqëndrueshme saqë shumë shkrimtarë nuk kishin mundësi tjetër veçse të iknin nga vendi ose të vuanin burgosjet, ose edhe të vriteshin nga shteti në të cilin jetonin.

Gjithsesi, edhe në orët më të errëta të sundimit serb në Prishtinë, letërsia vazhdoi të botohej. Për shqiptarët e Kosovës, librat ishin një akt rezistence ndaj hegjemonisë kulturore serbe. Serbët, nga ana e tyre, ishin mësuar t'i përçmonin shqiptarët si një "racë inferiore" dhe çdo ide për një letërsi artistike në shqip e shikonin si qesharake. Në këtë mënyrë, sapo Beogradi e humbi autoritetin e tij politik mbi shqiptarët e Kosovës, ai nuk e pati më mundësinë, ndoshta as edhe ndonjë interes të veçantë, për të ndaluar apo censuruar librat në shqip. Por, pasi Beogradi vuri nën zotërim dhe likuidoi në mënyrë të paligjshme Entin Botues Rilindja, pushuan, sikundër kishte ndodhur edhe në Shqipëri, edhe kontrollet e cilësisë së botimit. Megjithatë librat vazhdonin të qarkullonin. Të ekspozuar mbi kapakët e makinave në cepat e rrugëve, ata shiteshin anë e kënd Kosovës në mënyrë të paorganizuar. Çdo gjurmë e tyre zhdukej në çast menjëherë pasi policia serbe vendoste të ndërhynte. Shqiptarët e Kosovës ishin krenarë për çdo libër, ndonëse pak prej tyre vërtet lexoheshin.

Pas çlirimit në qershor 1999, ndoshta në një masë modeste, tregu i librit u zhvillua lirisht. Në fushën e letërsisë artistike, në lidhje me shitjet e librit, Kosova- me rreth dyzet përqind të të gjithë popullsisë shqiptare në Ballkan- përfaqëson vetëm dhjetë përqind të tregut. Kësisoj, nga pikëpamja e proporcioneve ajo mbetet shumë pas Shqipërisë.

Nëse dikush do të pyeste se ku qëndron arritja më e madhe e kulturës së shkruar shqiptare gjatë këtyre dekadave të fundit, përgjigjja sigurisht që do të ishte, "Poezi, këtu, atje dhe kudo". Në ndryshim nga letërsitë perëndimore, përmbledhjet poetike përbëjnë përqindjen më të lartë të prodhimit letrar në të gjitha qendrat e mëdha ku botohet letërsi shqipe: Tiranë, Prishtinë, Shkup, Shkodër dhe Tetovë. Madje edhe në kushtet e ashpra të ekonomisë së tregut të lirë në një vend të prapambetur, poezia shqiptare ia ka dalë të mbijetojë dhe të ruajë rëndësinë e saj.



Kur emigrantët e varfër dhe të paarsimuar shqiptarë mblidhen në klubet e tyre shpesh herë të zymtë e plot tym cigareje në Evropën perëndimore apo në Amerikën veriore, kjo në më të shumtën e rasteve ndodh për të dëgjuar poezi. Këtu e gjen shprehjen e tij shpirti i kombit shqiptar.

Për herë të parë, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, letërsia shqiptare bashkëkohore tani është e lirë të zhvillohet dhe të shkojë lirisht në rrugën e saj. Përgjatë dekadave të diktaturës së Hoxhës dhe deri në muajt e fundit të sundimit serb në Kosovë, kufiri midis dy gjysmave të kombit shqiptar mbahej i vulosur nga sundimtarët përkatës. Të rrallë ishin ata që mund ta kalonin atë pa vuajtur pasoja politike. Krahasuar me të, Muri i Berlinit që ndante dy gjysmat e Gjermanisë ishte një shoshe. Rrjedhoja e kësaj ndarjeje të imponuar ishte zhvillimi i dy kulturave dhe letërsive shqiptare mjaft të ndryshme. Qysh nga 1999, të dy vendet kanë filluar ta njohin njëri tjetrin dhe kanë filluar të mësohen mes veti. Qytetarët kanë mundësi tani të takohen dhe të lidhen mes tyre. Për popullsinë e gjerë nuk ka qenë e lehtë, ndërkohë që shumë paragjykime kanë ngritur krye, por shkëmbimi i eksperiencave ka qenë veçanërisht frymëmarrës dhe i frytshëm për shkrimtarët shqiptarë nga të dyja anët e kufirit. Për herë të parë, ata janë bërë pjesëtarë të një kulture letrare të përbashkët, një kulturë që tani është dyfish më e gjerë, dhe shumë më e larmishme se sa ato më të voglat që ishin përjetuar më parë. Letërsia shqiptare është pasuruar. Bima e saj e brishtë, trupi dhe rrënjët e së cilës shpesh të shkulura nga toka e zhuritur, ka filluar të lulëzojë sërish.

## **Bibliografia**

- Bihiku, Koço dhe të tjerë (red), Historia e letërsisë shqiptare të realizimit socialist. Tiranë 1978.
- Idem. History of Albanian Literature, Tiranë 1980 (përkthimi frëngjisht Tiranë 1980; përkthimi italisht Tiranë 1981; përkthimi rusisht Tiranë 1983).
- Elsie, Robert, History of Albanian literature. Boulder, New York 1995.
- Idem, Studies in Modern Albanian Literature and Culture. Boulder, New York 1996.
- Idem, Histori e letërsisë shqiptare. Përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë, pejë 1997.
- Idem, Nuk bëhesh i famshëm vetëm kur përkthehesh jashtë, në Ars, e përkohshme letrare, Tiranë, 26 tetor 2003.
- Idem, Albanian Literature: A Short History. London 2005.
- Idem (ed), Balkan Beauty, Balkan Blood: Modern Albanian Short Stories. Translated from the Albanian. Writings from an Unbound Europe. Evanston. 2006.

Idem, Letërsia shqipe: një histori e shkurtër. Përkthet nga anglishtja Majlinda Nishku. Tiranë 2006.

Elsie, Robert/ Janice Mathie-Heck, Contemporary Verse from Albania, në: Transcript, European Internet Review of Books and Writing, vol. 24, 4 maj 2007 <http://www.transcript-review.org>

Pipa, Arshi, Contemporary Albanian literature. New York 1991.

Shuteriqi, Dhimitër (red), Historia e letërsisë shqiptare që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacionalçlirimtare. Tiranë 1983. Rishtypur në Prishtinë 1990.

Shuteriqi, Dhimitër/Koço Bihiku/Mahir Domi (red), Historia e letërsisë shqipe, 2 vëll. Tiranë 1959, 1960. Rishtypur në Prishtinë 1975.

[in: *Historia e Shqiptarëve: gjendja dhe perspektivat e studimeve*. Përgatitur nga Oliver Jens Schmitt dhe Eva Anne Frantz. Botim në shqip u përgatit nga Pandeli Pani dhe Artan Puto. Tirana: Botime Përpjekja, 2012. f. 255-266. Përkthyer nga Artan Puto nga *Albanian Literary History and Albanian Literary Culture: Observations on Recent Developments*, in: Oliver Jens Schmitt & Eva Anne Frantz (ed.): *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung*. Südosteuropäische Arbeiten, 140. Munich: R. Oldenbourg, 2009, p. 215-224.]